

REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVO	
MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEHNOLOGIJE MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARCHIVE-ARCHIVE SECTOR	
Njësia Org. Org. Jedinica Org Unit	Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.
018	1580
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	Data: Datum: Date:
2	07, 05, 2015
Prishtinë / a	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstva za Obrazovanje  
Nauku i Tehnologiju - Ministry of Education, Science and Technology

*Kabineti i Ministrit /Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister*

Nr. 184/018  
Datë: 7 maj 2015

Ministri i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të nenit 5 paragrafit 5 të Ligjit nr. 04/L-032 të Arsimit Parauniversitar në Republikën e Kosovës, në bazë të Udhëzimit administrativ 10/2008 për emërtimin dhe riemërtimin e shkollave dhe në bazë të kërkesës së DKA-së në Rahovec datë 27 tetor 2014, nxjerr:

**VENDIM**

1. Shkolla fillore dhe e mesme e ulët në Pastasel, Komuna e Rahovecit emërtohet "Milaim Krasniqi".
2. Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Komisioni për emërtimin dhe riemërtimin e shkollave në MASHT në mbledhjen e mbajtur më 29 prill 2015, rishqyrtoi kërkesën e Këshillit të shkollës fillore dhe të mesme të ulët në Pastasel, Komuna e Rahovecit për ndërrimin e emrit të kësaj shkolle, nga shkolla fillore dhe e mesme e ulët "Jusuf Gërvalla" në shkolla fillore dhe e mesme e ulët "Milaim Krasniqi". Komisioni konstatoi se lënda ka kaluar nëpër procedurë të rregullt. Këshilli i shkollës ka propozuar tre emra të merituar, duke i dhënë prioritet emrit të dëshmorit Milaim Krasniqi. DKA në Rahovec ka përkrahur propozimet. Komisioni i MASHT-it përkrahu propozimin që kjo shkollë të mbajë emrin "Milaim Krasniqi". Duke u mbështetur në këto argumente u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

**Udhëzime juridike**

Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh në Komisionin për ankesa dhe parashtresa pranë MASHT-it.

Prof. dr. Arsim Bajrami, *Ministër*



**Vendimi ju dorëzohet:**

1. Drejtorisë Komunale të Arsimit në Rahovec;
2. Shkollës fillore dhe të mesme të ulët "Milaim Krasniqi" në Pastasel, Komuna e Rahovecit;
3. Komisioni për emërtimin dhe riemërtimin e shkollave në MASHT;
4. Arkivit në MASHT